REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 121/17
Datë/Datum. 31.05.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW

DATË/A:	**19.05.2017**
REFERENC-Ë:	**121/17**
PËR/ZA/TO:	**-Menaxherin e Prokurimit-Komuna e Mitrovicës** **-OE "RSM Company"shpk në Prishtinë**
NGA/OD/FROM:	**Tefik Sylejmani – Kryetar i PSH-së**
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	**Njoftim**

Me datë 21.04.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka pranuar ankesën e parashtruar nga OE "RSM Company"shpk me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Shenjëzimi horizontal dhe vertikal në qytetin e Mitrovicës", me nr. të prok.642/17/010/521,të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Komuna e Mitrovicës,duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 59,60,61,68 dhe 70 të LPP-ës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 dhe 114 të LPP-së, më dt. 28.04.2017, ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të shqyrtuar aktivitetin e prokurimit "Shenjëzimi horizontal dhe vertikal në qytetin e Mitrovicës", me nr. të prok.642/17/010/521,të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Komuna e Mitrovicës, për të shqyrtuar ankesën si dhe vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore të OE ankues.

Eksperti shqyrtues në raportin e ekspertizës, të dt. 08.15.2017,ka dhënë mendimin se AK me rastin e zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 59,61,60 të LPP-ës dhe i rekomandon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar dhe të lënda të kthehet në ri-tenderim.

Autoriteti kontraktues Komuna e Mitrovicës, përmes e-malit njofton panelin shqyrtues se të njëjtit pajtohen me raportin e ekspertit shqyrtues për aktivitetin e prokurimit"Shenjëzimi horizontal dhe vertikal në qytetin e Mitrovicës", me nr. të prok.642/17/010/521.

Po ashtu OE ankues "RSM Company"e njofton panelin shqyrtues se të njëjtit pajtohen me mendimin ekspertit shqyrtues që ky aktivitet i prokurimit të ri-tenderohet.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, njofton autoritetin kontraktues Komunën e Mitrovicës dhe OE ankues"RSM Company"se procedura e ankesës përfundon në këtë fazë konform nenit 115 pika 3 të LPP-së.

Autoriteti kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim panelin shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me ketë aktivitet të prokurimit nga ana e komisionit ri-vlerësues.

Operatorit ekonomik ankues "RSM Company" me seli në Prishtinë, konform nenit 118 pika 3 i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës.

Urdhërohet, OE ankues që konform nenit 36 pika 5 e Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.